



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality Assambly  
Hani i Elezit



01/Nr. 250/2023  
Data : 10.01.2023

## PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e dymbëdhjetë -XII- për vitin 2022 e Komitetit për Politikë dhe financa , mbajtur me datë 14.12.2022 me fillim pune ne ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës), **Natyra Kalisi** (Drejtoreshë për Administratë), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për buxhet dhe Finaca), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik), **Kimete Kuka - Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Ajete Berisha** (Udhëheqëse e Personelit), **Liridona Ballazhi** (Shefe në Kabinetin e Kryetarit të Komunës), **Bashkim Sopa** (Zyrtar për Informim), Përfaqësuesi i OSB-së.

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Plani i punës së ekzekutivit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2023.
3. Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2023.
4. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim të pronave të Kuvendit të Komunës për vitin 2023.
5. Raporti i auditorit të brendshëm për vitin 2021 dhe gjashtë mujorin e 2022.
6. Plani i veprimit të rekomandimeve të auditorit të brendshëm për vitin 2021 dhe gjashtë mujorin 2022.
7. Raporti për planin e integritetit për vitin 2022.
8. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin.

**Sherif Berisha** thekson:- kërkoj që në rend të punë të shtohet edhe një pikë e cila ka të bëjë informatë për gjashtëmbëdhjetë ditët e aktivizimit kundër dhunës në baza gjinore.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për rendin e punës, nëse nuk ka e hedh në votim pikën shtesë; rezultati i votimit ishte një zëri. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

**Procedojmë me këtë rend të punës:-**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Plani i punës së ekzekutivit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2023.
3. Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2023.
4. Propozimi vendim për dhënien në shfrytëzim të pronave të Kuvendit të Komunës për vitin 2023.
5. Raporti i auditorit të brendshëm për vitin 2021 dhe gjashtë mujorin e 2022.
6. Plani i veprimit të rekomandimeve të auditorit të brendshëm për vitin 2021 dhe gjashtë mujorin 2022.
7. Raporti për planin e integritetit për vitin 2022.
8. Informatë për gjashtëmbëdhjetë ditët e aktivizimit kundër dhunës në baza gjinore.
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### **U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR**

2. Plani i punës së ekzekutivit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2023.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- secila drejtori e ka bërë planin , ndërsa objektivat janë të shënuara dhe kryesore janë pesë pika. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTU PLANI I PUNËS SË EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2023 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

3. Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2023.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTU PLANI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2023 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**



#### 4. Propozim vendim për dhënie në shfrytëzim të pronave të Kuvendit të Komunës për vitin 2023.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nexhmedin Daci** thekson:- ju e dini që komuna jonë ka pakë prona dhe kjo çështje lidhet edhe me performancën e komunës që për çdo vit komunat konkurojnë për me qenë përfitues të grantit të performancë dhe është kërkesë ligjore që komuna ta ketë të publikuar listën e pronave në vebfaqe të komunës pasi të miratohet në kuvend. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Refet Kalisi** thekson:- a do të ketë taksë dhe vlerësim.

**Nexhmedin Daci** thekson:- komisioni i cili do të formohet do ta cakton edhe çmimin.

**U VOTU PROPOZIM VENDIMI PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONAVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2023 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

#### 5. Raporti i auditorit të brendshëm për vitin 2021 dhe gjashtë mujorin e 2022.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- në mungesë të auditorit të brendshëm kemi auditorët nga Ministria e Financave të cilët kanë bërë auditivin për vitin 2021 dhe gjashtë mujorin e vitit 2021. Nga ky auditim që është bërë janë dhënë nëntë të gjetura. Materialin e keni të detale dhe nëse keni ndonjë sugjerim mund të parashtroni.

**Refet Kalisi** thekson:- rekomandimet të cilat i ka dhënë auditori i brendshëm a kemi mundësi për me i plotësuar në mënyrë që të dalim mirë në performancën e komunës.

**Lindita Ballazhi** thekson:- jemi duke vepruar që mos ti kemi këta të gjetura në vitet e ardhshme . plani i ndarjes së subvencioneve nuk ka qenë dhe e kemi hartuar dhe e kemi dorëzuar pranë zyrës së kryeministrit kemi përcaktuar një zyrtarë për monitorimin e subvencioneve. Sa i përket rekomandimeve të tjera jemi në proces.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTU RAPORTI I AUDITORIT TË BRENDSHËM PËR VITIN 2021 DHE GJASHTË MUJORIN E 2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

## **6. Plani i veprimit të rekomandimeve të auditorit të brendshëm për vitin 2021 dhe gjashtë mujorin 2022.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- siç e ceka te pika paraprake i kemi nëntë të gjetura e që prej tyre kemi filluar disa t'i zbatojmë. Disa janë përfunduar dhe nuk do ti kemi të gjetura. Kemi bërë planin e veprimit për ato rekomandime të auditorëve i dhe kemi caktuar departamentet përgjegjëse për rekomandimet dhe datën se kur planifikohen të zbatohen rekomandimet.

**Sherfi Berisha** thekson:- a është formuar komisioni për hartimin e planit të veprimit.

**Lindita Ballazhi** thekson:- është formuar komisioni për hartimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTU PLANI I VEPRIMIT TË REKOMANDIMEVE TË AUDITORIT TË BRENDSHËM PËR VITIN 2021 DHE GJASHTË MUJORIN 2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

## **7. Raporti për planin e integritetit për vitin 2022.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Natyra Kalisi** thekson:-përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam me shtuar.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTU RAPORTI I PLANIT PËR INTEGRITET QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

## **8. Informatë për gjashtëmbëdhjetë ditët e aktivizimit kundër dhunës në baza gjinore.**

**Kryesuesi** thekson:- këtë pikë e diskutojmë në kuvend të komunës sepse nuk kemi material të përgatitur.

## **9.Të ndryshme**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin

**Sherfi Berisha** thekson:- kërkoj që të na bëhet një zyre e përbashkët në objektin e komunë për LDK, AAK, dhe LVV. Është bërë shpallja qytetarë nderë e që unë nuk kam vërejtje në atë drejtim dhe e di që nuk ke bërë keq por me u pa diskutuar dhe me pas kaluar nëpër kuvend do të kishte qenë më mirë .



**Mehmet Ballazhi** thekson:- nuk është bërë në mënyrë protokollare shpallja qytetarë nderi por Kryetari i Komunës ka drejtë me marr vendim për me nderuar dikend dhe është formë nderimi, ndërsa janë rregullat që e përcaktojnë shpalljen qytetarë nderi. Është lloj mirënjohje që shpallet qytetarë nderi dhe mundesh me ja lënë emrin si të duash , qytetarë nderi, qytetarë i përgjegjshëm, ndërsa kur të bëhet protokollare atëherë mund të flasim. E kam parë që është përfulur kjo çështje dhe nuk jam marr sepse nuk ka protokoll për këtë çështje por është një mendim i imi për me shpallur një mirënjohës për punën që e kanë bërë për angazhimet. Nuk është problem çështja e zyrave por duhet ta dimë se a kemi dhe nëse ka zyre është mirë që të jetë funksionale e jo vetëm me pasur një zyre . Të gjitha OJQ-ve ju ka ofruar zyre në shtëpinë e kulturës por besoni që kanë marr zyre dhe asnjë herë se ka hapur.

**Refet Kalisi** thekson:- çështja e zyrës është pak problem sepse ndoshta ndahem prej opozitës dhe mundem mos me ardhur në atë zyre pastaj shtrohet pyetja se kujt i mbetet ajo zyre edhe pse unë jam për me pasur një zyre por në të ardhmen mundemi me pasur probleme .

**Sherif Berisha** thekson:- është e domosdoshme me pasur një zyre dhe në atë zyre me figuruar të gjitha subjektet politike.

**Natya Kalisi** thekson:- i kemi tridhjetë e gjashtë zyre dhe gjendja në komunë nuk është aq e mirë për shkak se ka zyre që janë katër zyrtarë , po ashta ka zyre që punojnë nga katër zyrtarë dhe hapësira është shumë e ngushtë . I kemi edhe tri zyre të cilat përdoren prej KFOR-it, OSB-së, dhe një zyre për bashkëpunimet me IPA fondet.

**Sherif Berisha** thekson:- kërkoj nga drejtorja për shërbime publike që të na informon për punimet që janë zhvilluar për çështje të ujit në fshatin Gorancë. Fëmijët të cilët vinë në shkollë me kombibusë nga vendi i quajtur Kashan, janë më shumë se sa i ka të planifikuar kombibusi për me i bartur pra është numër i madh. Është mirë inspektorati i komunës me u marr me këtë çështje.

**Arsim Dernjani** thekson:- kemi biseduar me kompaninë “Bifurkacioni” që me marr në mbykëqyrje , mirëpo ata kanë potencuar që është problem me marr në menaxhim “Bifurkacioni” sepse duhet të jenë 600 konsumatorë për me punësuar një inkasantë. Punët janë kryer sipas paramasës.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- për çështje të kombibusit nuk kemi pasur ndonjë ankesë për këtë çështje.

**Refet Kalisi** thekson:- kërkoj informacion për çështjen e ujit në Han të Elezit.

**Arsim Dernjani** thekson:- KEDSI i ka kryer punimet dhe ka mbetur që nga inxhinieri me u bërë ritestimi një javë ditë. Përmes telefonit jam mundur për me kontaktuar por nuk kam mundur po ashtu edhe imell adresë i kam shënuar por ende nuk ka ardhur.

**Kryesuesi** thekson:- analizat e ujit të cilat janë bërë në fshatin Seçishtë dhe rezultat kanë ardhur dhe është mirë të na njoftoni.


**Kimete Kuka - Hasallari** thekson:- analizat janë dërguar për secilin burim dhe kanë rekomanduar me u bërë dezinfektimin e ujit me përjashtim në fshatin Gorancë janë rregull. Tetë burime i kemi rekomanduar që mos me u pirë ndërsa tjerat janë brenda parametrave.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 12:39 .

**Procesmbajtësi**

**Ayni Bushi**



**Kryesuesi i Komitetit**  
**Florim Shkreta**

